



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

SISTEMI I MENAXHIMIT TË PERFORMANCËS KOMUNALE



Raporti i performancës së komunave

JANAR-DHJETOR 2019

Gusht, 2020

Hartuesi i raportit:

Ministria e Pushtetit Lokal

Mbikëqyrja:

Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme, MPL

Përpunimi i të dhënave:

Departamenti për Performancë dhe Transparencë Komunale

Raporti (pjesa e përgjithshme) u hartua nga:

Diellor Gashi, Udhëheqës i Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale

Mbledhja, përpunimi, verifikimi i të dhënave dhe hartimi i raporteve individuale të komunave, u kryen nga:

Lazar Mitic, Zyrtar për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MPL

Haxhi Krasniqi, Zyrtar i Lartë për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MPL

Edina Ibishi, Zyrtare për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MPL

Shqiponja Vokshi, DEMOS

Jetmir Bakija – Konsulent/DEMOS

Berat Abdiu – Konsulent/DEMOS

Copyright 2020:

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e dokumentit nuk mund të kopjohet, shumëzohet dhe të përdoret, në cilën do formë (elektronike dhe fizike) apo të përshkruhet pa lejen me shkrim të autorit - MPL.

Përmbajtja

HYRJA	4
BAZA JURIDIKE PËR RAPORTIN E PERFORMANCËS.....	5
QËLLIMI	5
METODOLOGJIA	6
 KAPITULLI I.....	7
1. PERFORMANCA E QEVERISJES LOKALE BAZUAR NË SISTEMIN E MENAXHIMIT TË PERFORMANCËS KOMUNALE (SMPK)	7
 2. PËRMBLEDHJE E PERFORMANCES SIPAS KOMUNAVE.....	11
 KAPITULLI II	
ANALIZË E TREGUESVE SIPAS FUSHAVE.....	15
<i>Fusha 1: Shërbimet Publike Administrative</i>	<i>15</i>
<i>Fusha 2 – Transparenca Komunale.....</i>	<i>16</i>
<i>Fusha 3 – Përgjegjshmëria Komunale.....</i>	<i>18</i>
<i>Fusha 4 – Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare</i>	<i>19</i>
<i>Fusha 5 – Kulturë, Rini dhe Sport.....</i>	<i>21</i>
<i>Fusha 6 – Menaxhimi i Fatkeqësive</i>	<i>22</i>
<i>Fusha 7 – Planifikimi Hapësinor.....</i>	<i>23</i>
<i>Fusha 8 – Hapësirat Publike</i>	<i>24</i>
<i>Fusha 9 – Infrastruktura Rrugore</i>	<i>25</i>
<i>Fusha 10 – Transporti Publik</i>	<i>26</i>
<i>Fusha 11 – Parkingjet Publike.....</i>	<i>27</i>
<i>Fusha 12 - Uji i pijshëm.....</i>	<i>28</i>
<i>Fusha 13 - Kanalizimi.....</i>	<i>29</i>
<i>Fusha 14 – Menaxhimi i Mbeturinave</i>	<i>30</i>
<i>Fusha 15 – Mbrojtja e Mjedisit.....</i>	<i>31</i>
<i>Fusha 16 – Përfaqësimi Gjinor.....</i>	<i>32</i>
<i>Fusha 17– Arsimi Parauniversitar.....</i>	<i>33</i>
<i>Fusha 18 – Kujdesi Primar Shëndetësor.....</i>	<i>35</i>
<i>Fusha 19 – Zhvillimi Ekonomik Lokal</i>	<i>36</i>
 REKOMANDIMET	38
 SHTOJCË: % E TREGUESVE SIPAS FUSHAVE	41

Hyrja

Raporti i performancës komunale prezanton rezultatet e komunave nëpërmjet 19 fushave të kompetencave që janë nën përgjegjësi të tyre. Vitin e kaluar, Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale kaloi nëpër një procesi të rishikimit të plotë, ashtu siç ishte paraparë në planin vjetor të punës së ministrisë. Objektivi i zhvillimit të sistemit ishte përfshirja e sa më shumë fushave të kompetencave komunale dhe treguesve që synonin së pari të pasqyronin gjendjen reale të ofrimit të shërbimeve publike, dhe së dyti rezultatet e fituara të shërbenin si burime të rëndësishme të të dhënave për përmirësim të qeverisjes në sektorët në nevojë.

Procesi i rishikimit prodhoi ndryshime të dukshme si nga përmbajtja e komponentëve të matjes, ashtu edhe për nga rregullativa juridike. Në hap me rishikimin e sistemit, u hartua Rregullorja e re për sistemin e menaxhimit të performancës komunale. Me këtë rregullore u integrua edhe skema e grantit të bazuar në performancë. Njëherësh u përcaktuan dispozitat për vënien në funksion të sistemit elektronik për menaxhimin e të dhënave për performancë. Për më tepër, nga një sistem me 14 fusha dhe 77 tregues, sistemi u zgjerua në 19 fusha që përmbajnë 119 tregues.

Edhe në këtë cikël të matjes dhe vlerësimit të punës së komunave, shtrirja e të dhënave reflekton të arriturat e komunave në kuadër të treguesëve, rezultateve (nënobjektivave) dhe *fushave* sipas kompetencave vetanake përkatëse.

Performanca komunale bazohet në të dhënat e ofruara dhe të dokumentuara nga vetë komunat. Ky raport bënë prezantimin e të arriturave vetëm për vitin 2019, por në shumë raste nxjerr krahasime me vitet e mëparshme. Raporti synon të vë në pah dy çështje kryesore të menaxhimit të çështjeve publike: 1) Mënyrën e qeverisjes së komunave vlerësuar sipas legjislacionit të zbatueshëm dhe 2) Ofrimin e shërbimeve në aspektin sasior dhe cilësor, kur është e mundur.

Të dhënat shërbejnë për të pasqyruar performancën brenda komunës, për të ngritur krahasime rreth trendit të zhvillimit të qeverisjes lokale në përgjithësi dhe përmbajnë elemente të rëndësishme të llogaridhënies së të zgjedhurve lokal para qytetarëve. Gjithashtu, raporti informon qytetarët për pritjet e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve nga institucionet e tyre lokale.

Pavarësisht rezultateve, është në autoritetin e institucioneve lokale që të vendosin për prioritetet e tyre të punës, mënyrën e ofrimit të shërbimeve për qytetarët dhe angazhimin e burimeve përkatëse. Raporti nxjerrë përfundimet e përgjithshme për shkallën e të arriturave të komunave dhe jep rekomandimet përkatëse për përmirësimin e shërbimeve në bazë të rregullave juridike në fuqi apo standardeve të kërkuara qeverisëse.

Baza juridike për raportin e performancës

SMPK normohet me Rregulloren e Ministrisë së Pushtetit Lokal Nr. 01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe Skemës së Grantit për Performancë Komunale.

Sistemi është i ndërtuar mbi tetë parime themelore:

- Parimin e ligjshmërisë;
- Parimin e transparencës;
- Parimin e subsidiaritetit;
- Parimin e meritës;
- Parimin e efikasitetit dhe efektivitetit;
- Parimin e vlefshmërisë;
- Parimin e barazisë; dhe
- Parimin e zbatueshmërisë.

Rregullorja përcakton të drejtën e autoritetit mbikëqyrës për të kërkuar informata të cilat i shërbejnë matjes dhe vlerësimit të performancës së komunave. Rregullorja përcakton strukturat organizative përgjegjëse të komunave për raportim në kuadër të SMPK-së.

Qëllimi

Matja e performancës nuk ka të bëjë thjesht me mbledhjen e të dhënave që lidhen me një qëllim afatshkurtër të menaxhimit. Qëllimi i kësaj matje është të nxjerr në pah fushat ku shërbimet komunale kanë nevojë për mbështetje dhe avancim, si dhe fushat ku duhet orientuar investimet afatmesme dhe afatgjata. Të dhënat mund të ndihmojnë komunitatet të përmirësojnë planifikimin dhe të orientojnë prioritetet e tyre në sektorët e nevojshëm për vitet e ardhshme.

Sistemi shërben edhe për autoritetet qendrore për të planifikuar projektet sipas vlerësimeve reale, kritereve të bazuara në nevojën për investime dhe shpërndarjes më të drejtë të parasë publike.

Edhe pse ky sistem vjen me një grant të performancës të përbërë nga buxheti i Ministrisë dhe buxhetet e donatorëve, efekti më i madh i rritjes së performancës mund të jetë si rezultat i evidentimit, krahasimit dhe publikimit të të dhënave të fushave të ndryshme të qeverisjes. Në fakt, matja e performancës synon të jap përgjigje në pyetjet se:

- Në çfarë niveli kanë performuar komunitatet?
- Nëse komunitatet po i arrijnë objektivat e tyre?
- Nëse proceset menaxhuese janë në pajtim me ligjin?
- Cilat duhet të jenë veprimet e nevojshme që duhet bërë në të ardhmen?

Prandaj, përmes vlerësimeve të tilla dhe monitorimit të punës së administratës në përgjithësi, apo edhe të zgjedhurve lokal, supozohet të rritet niveli i përgjegjësisë dhe llogaridhënies, ashtu që e gjithë kjo të reflektoj në qeverisje më të mirë dhe shërbime sa më cilësore.

Metodologjia

Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) është i ndërtuar nga MPL në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtar. MPL ka përcaktuar dhe normuar metodologjinë për përgatitjen, mbledhjen, përpunimin, verifikimin dhe raportimin e të dhënave në SMPK.

Udhëzimet për mbledhje dhe raportim të të dhënave janë dhënë përmes: trajnimeve për koordinatorët komunal për performancë dhe zyrtarët raportues. Në hap me këtë janë përgatitur udhëzimet e shkruara të cilat shpjegojnë në detaje gjithë skenarin e funksionimit të SMPK-në.

Procesi i përgatitjes së raportit është bërë përmes hapave si në vijim:

1. Përgatitjes së bazës së të dhënave të SMPK-së;
2. Hartimit të metodologjisë për sigurimin e cilësisë së të dhënave;
3. Shpërndarjes së formularëve dhe udhëzimeve për raportim në komuna;
4. Mbajtjes së trajnimeve për koordinatorët komunal;
5. Hapjes së periudhës së raportimit;
6. Raportimit nga komunat;
7. Mbledhjes së të dhënave nga komunat;
8. Përpunimit të të dhënave, pastrimit të tyre dhe analizimit;
9. Përmbjlljes së fazës së verifikimit dhe dokumentimit të të dhënave;
10. Përmbjlljes së fazës së konsultimit paraprak dhe ankesave;
11. Finalizimit të raportit.

Raportimi dhe dokumentimi i të dhënave për SMPK është bërë nga komunat pas udhëzimeve të MPL-së. Procesi i mbledhjes, dokumentimit dhe raportimit të të dhënave brenda institucioneve të ndryshme komunale është koordinuar nga koordinatori komunal për performancë. Të dhënat e raportuara janë autorizuar nga kryetarët e komunave.

Para finalizimit të raportit nga MPL, të dhënat e përpunuara janë dërguar në secilën komunë si mundësi për korrigjim dhe ofrim të vërejtjeve/ankesave.

Saktësia e të dhënave të prezantuara në këtë raport është në përgjegjësi të komunës. MPL ka verifikuar në dy forma të dhënat e raportuara:

- Dokumentimit përmes monitorimit të ueb-faqeve zyrtare;
- Shqyrtimit të dokumenteve zyrtare të bashkëlidhura me formularët e plotësuar;
- Shqyrtimit të dokumenteve shitesë të kërkuara për të dhëna të caktuara;
- Krahasimit të të dhënave me dokumente të tjera zyrtare të institucioneve publike;
- Krahasimit me raportet e tjera zyrtare të MPL-së;
- Për të dhëna të caktuara janë kontaktuar direkt edhe zyrtarët përgjegjës në komuna.

Për vitin 2019 kanë raportuar 36 komuna, ndërsa 2 komuna (Mamushë dhe Dragash) nuk kanë ofruar të dhëna.

Disa nga të dhënat e raportuara nga komunat me shumicë serbe, sidomos në fushën e arsimit dhe shëndetësisë, të cilat nuk korresponduan me ofrimin e shërbimeve sipas legjislacionit pozitiv të Republikës së Kosovës, janë shpallur nule dhe u aplikua vlera 0% e performancës.

Kapitulli I

1. PERFORMANCA E QEVERISJES LOKALE BAZUAR NË SISTEMIN E MENAXHIMIT TË PERFORMANCËS KOMUNALE (SMPK)

Vetëqeverisja lokale është një fushë mjaft e gjerë e ushtrimit të autorizimeve publike e rregulluar me Kushtetutë dhe ligje të tjera të cilat përcaktojnë funksionet dhe kompetencat e organeve të pushtetit lokal. Sipas Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje lokale, komunat ushtrojnë funksione të gjera dhe mjaft komplekse qeverisëse. Kontakti më i shpeshtë i qytetarëve me shtetin bëhet përmes administratës komunale. Komunat përballen me kërkesa të shumta të qytetarëve dhe palëve të tjera të interesit. Jo rastësisht koha jonë njihet edhe si kohë e administratës. Volumi i madh i kërkesave të parashtruara nga qytetarët, bënë që aktiviteti administrativ i organeve përgjegjëse në komuna të jetë mjaft aktiv. Për shkak të dendësisë së madhe të kërkesave të qytetarëve cilado formë e mbikëqyrjes së veprimtarisë së organeve komunale, do të nxiste nivelin e përgjegjësisë në funksion të rritjes së efikasitetit të ofrimit të shërbimeve.

Nëntëmbëdhjetë fushat e sistemit të menaxhimit të performancës komunale përmbledhin një spektër mjaft të gjerë të kompetencave të komunave. Për më tepër, ato shprehin grupin e të drejtave dhe obligimeve që komunat i ushtrojnë në shërbim të qytetarëve mbi bazën e kompetencave ligjore¹. Indikatorët e përdorur japin informacione të konsiderueshme për nivelin e shërbimeve të ofruara. Të dhënat e fituara nga ky sistem japin indikacione të qarta për menaxhmentin komunal dhe palët e interesit rreth ndërhyrjeve, shtrirjes së prioritetëve dhe arritjes së objektivave të synuara. Prandaj, analizat e të dhënave të fituara nga ky proces duhet të kalojnë në një proces të vlerësimit nga ana e autoriteteve komunale, për t'i shqyrtuar në mënyrë sistematike dhe objektive, si dhe për të reflektuar në masa konkrete përmes programeve pasuese qeverisëse dhe në nivel të prioritetëve.

Për të nxitur përmirësimin e ofrimit të shërbimeve nga organet komunale u krijua Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale dhe që nga viti 2009 u aplikuan matje të performancës. Sistemi ka evoluar ndër vite duke u plotësuar me fusha, rezultate dhe tregues të ri. E veçanta e matjes dhe vlerësimit të këtij viti është Sistemi i Sigurimit të Cilësisë, i mbështetur në instrumente më rigorozë të verifikimit të të dhënave.

Po ashtu, këtë vit është bërë zgjerimi i bazës së sistemit të performancës me fusha të reja, kjo për shkak të prioritetëve strategjike të vendit dhe nevojës për përkrahje në fusha specifike të kompetencave komunale. Me këtë rast, në sistem u inkorporuan edhe fusha e përgjegjshmërisë komunale, përfaqësimit të barabartë gjinor, arsimit parauniversitar, shëndetësisë primare dhe zhvillimit ekonomik lokal². Njëherësh u integrua edhe fusha e

¹ Rregullore Nr.01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale, neni 5.1.1

² Zhvillimi i treguesve u realizuar në bashkëpunim me ministritë përkatëse, përkatësisht Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik

përfaqësimit të barabartë gjinor, si dhe në përgjithësi një sistem i ndërtimit të treguesve sipas komponentëve gjinor.

Sigurisht që performanca e komunave nga viti në vit ka ardhur duke u rritur. Nëse analizohet performanca në mes të viteve 2017-2018, atëherë vërehet trend pozitiv i arritjeve të komunave. Për dallim me vitin 2017, ku përqindja në 14 fusha të kompetencave komunale ishte 60.5%, në vitin 2018 komunat shënuan progres për 5.5%, apo 66% në total. Krahësimet e plota me vitin 2019 nuk kanë qenë të mundshme për shkak të ndryshimit të madh të fushave dhe treguesve. Në vijim është paraqitur figura me përqindjen e performancës së komunave në 14 fusha ndër vite, duke mos llogaritur 5 fushat e reja të përfshira në këtë sistem në vitin 2019, si vijon:




Figure 1. Performanca e komunave në 14 fusha gjatë vitit 2017, 2018, 2019

Nëse vlerësohet raporti në mes të fushave me tregues të ngjashëm, rezultatet nga figura 1 tregojnë për një rënie të performancës prej 4.8 % nga viti 2018. Kjo për shkak të faktorëve të shumtë, por kryesisht ndryshimit të instrumenteve matëse dhe treguesve të ri të inkuorporuar brenda fushave. Gjithashtu, numri i ndryshëm i komunave që kanë raportuar ndër vite, rezultojnë në shkallën e përgjithshme të performancës.

Sa i përket të dhënave të vitit 2019, performanca e përgjithshme e komunave në 19 fusha me 119 tregues të matjes është **58.79%**. Fusha me performancën më të lartë është menaxhimi i fatkeqësive natyrore dhe të tjera me 77.19%, derisa më e ulëta qëndron tek kanalizimi, me 36.51%³.

³ Në përqindjen e të arritjeve në fushën e kanalizimit ndikoi shpallja e pavlefshme për të gjitha komunat e të dhënave të raportuara për treguesin 13.2.1. - Vendbanimet e përfshira në sistemin për trajtim të ujërave të zeza, i cili u aplikua për herë të parë në këtë sistem. Gjatë procesit të vlerësimit u konstatua se një numër i madh i komunave nuk ofruan të dhëna të sakta për % e vendbanimeve të përfshira në sistemet e trajtimit të ujërave të zeza. Shumë komuna nuk kishin kuptuar drejtë qëllimin e treguesit, pasi që ngatërruan të dhënat për trajtimin e ujërave të zeza (impianteve), me të dhënat për përfshirjen e vendbanimeve në rrjetin e kanalizimeve.




Figure 2 Performanca e komunave në 19 fusha të matjes gjatë vitit 2019

Sipas figurës së mësipërme vërehet që edhe uji i pijshëm qëndron mirë në raport me fushat e tjera, me 73.10% të mbulimit të ekonomive familjare në vend⁴. Gjithashtu, menaxhimi i mbeturinave në nivelin prej 69.25% është në renditje të përafërt me vitin paraprak krahasuar me fushat e tjera, por për 14.06%⁵ më ulët për nga niveli i të arriturave.

Në kuadër të indikatorëve të qeverisjes, transparenca komunale në vitin 2019 del të jetë në vendin e tretë në krahasim me fushat e tjera. Krahasuar me vitin paraprak, kjo fushë qëndron më ulët për 3.3% (76.23% ishte në vitin 2018), por në nivel më të lartë sipas renditjes në krahasim me fushat e tjera. Në këtë fushë, të dhënat tregojnë për përmirësim të performancës

⁴ Në fushat si furnizimi me ujë dhe menaxhimi mbeturinave, komponentët e matjes janë kufizuar në ato veprime të cilat ndërlidhen me kompetencat ekskluzive të komunave. Treguesit nuk matin aspekte cilësore të këtyre shërbimeve, por kufizohen në kryesisht në shtrirje të shërbimit. Pra, nuk matet se Sa qytetarët kanë ujë të pijshëm, por Nëse ky shërbim ofrohet tek të gjitha subjektet. Furnizimi me ujë, aktualisht përmban indikatorë të cilët matin nivelin e planifikimit dhe realizimit të projekteve të komunave në këtë fushë si dhe shtrirjen e sistemit të ujit të pijshëm tek ekonomitë familjare, institucionet publike dhe ekonomitë biznesore, por jo edhe inkasimin e mjeteve e cila i përket kompanive rajonale të ujësjellësit të cilat janë në pronësi të nivelit qendror. Njësoj është vepruar edhe tek menaxhimi i mbeturinave, duke ditur se vetëm shtrirja e këtij shërbimi nuk përmbledh suksesin e të gjithë fushës. Në të ardhmen kjo fushë duhet të zgjerohet edhe me indikatorë të cilësisë të menaxhimit, ku mund të hyjnë ndarja e mbeturinave në burim, deponimi për të gjitha llojet e mbeturinave dhe përpunimi i tyre (riciklimi). Duke marrë parasysh se menaxhimi i mbeturinave është kompetencë e përzier në mes të nivelit lokal dhe atij qendror, në këtë fazë, matja dhe vlerësimi është kufizuar në nivelin e zbatimit të planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, shtrirjes së sistemit të grumbullimit të mbeturinave sipas ekonomive familjare, zbatimin e orarit të mbledhjes së mbeturinave, nivelin e inkasimit të mjeteve për mbledhje të mbeturinave dhe sasinë e deponimit të mbeturinave.

⁵ Rënia në përqindje në vitin 2019 shprehet për shkak të rritjes së indikatorëve në këtë fushë

në publikimin e njoftimeve, rregulloreve, vendimeve, planeve të buxhetit dhe dokumenteve të prokurimit. Në vitin 2019 u aplikua publikimi direkt i mbledhjeve të kuvendeve të komunave dhe ngarkimi i video-incizimeve në ueb-faqet zyrtare të tyre. Publikimi i kontratave është në rritje e sipër viteve të fundit, andaj vërehet të ketë përmirësime të dukshme në këtë fushë. Megjithatë performanca prej 72.93% tregon se komunat duhet të shtojnë intensitetin e punës së tyre për të qenë plotësisht transparente.

Fusha e transparencës ndërlidhet ngushtë me fushën e përgjegjshmërisë komunale, e cila vlerësohet me numër të madh të treguesve në kuadër të SMPK-së. Për dallim nga treguesit e transparencës të cilët kryesisht janë të orientuar në ofrimin e mundësisë për të qenë sa më afër bazës së informacionit, përgjegjshmëria komunale përmban tregues që synojnë matjen e llogaridhënies së organeve komunale si dhe aktivitetet e tyre për sigurimin e përfshirjes aktive të qytetarëve në vendimmarrje dhe proceset publike, për të formësuar atë që në teori njihet si 'qeverisje e konsenzusit'. Kështu, përderisa transparenca komunale qëndron relativisht mirë, përgjegjshmëria komunale në nivel prej 62.64%, tregon se llogaridhënia e komunave ndaj qytetarëve duhet të fuqizohet edhe më tutje. Posaçërisht, duhet të vihen në zbatim rregullat e reja për standardet minimale të konsultimit publik, me të cilat janë përcaktuar mënyrat dhe mjetet për zhvillimin e konsultimeve publike gjatë hartimit të projektakteve apo politikave në nivel lokal.

Gjatë periudhës raportuese, komunat kanë treguar efikasitet të lartë në trajtimin e lëndëve në procedurë administrative, por duhet rritur angazhimin për ofrimin e shërbimeve online. Fusha e shërbimeve administrative ka pasur shkallë të të arriturave në vlerë të përgjithshme prej 70.47%. Në këtë përqindje ndikoi treguesi i ri për ofrimin e shërbimeve përmes platformave elektronike dhe e-kiosqeve i shprehur në 30.56%.




Figure 3 Kategorizimi i fushave sipas nivelit të performancës

Performancë në nivel të mesëm komunat kanë shënuar në aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive, mbrojtje të ambientit, ofrimin e transportit publik lokal dhe shërbimeve sociale. Sektorët e vlerësuar në nivel të ulët të arriturave dhe që kanë nevojë për përmirësim janë në kuadër të fushës së kanalizimit, gjegjësisht në trajtimin e ujërave të zeza, pastaj fushës së

përfaqësimit të barabartë gjinor, arsimit parauniversitar (sidomos tek parashkolloret), kujdesit primar shëndetësorë, planifikimit hapësinor, por edhe përmirësimit të infrastrukturës së kanalizimit dhe asaj rrugore. Pavarësisht zhvillimit të kornizës ligjore dhe strategjike për barazi gjinore, të dhënat japin vlera të ulëta të përfaqësimit të barabartë të të dy gjinive në sektorët e qeverisjes lokale. Përfaqësimi i barabartë gjinor nuk ka marrë për bazë vetëm përfshirjen e grave në punësim në sektorin publik, por edhe qasjen e tyre në sektorë të tjerë. Treguesit në këtë fushë janë zgjeruar në planet lokale për barazi gjinore, qasjen e grave në subvencionet apo skemat stimuluese të komunave për zhvillim të bizneseve, përfaqësimin në këshillat lokale, në trupat (komisionet) komunale dhe të tjera.

Në anën tjetër, vlerësimi në kuadër të fushave me tregues të shërbimeve publike, thekson domosdoshmërinë për orientime të reja strategjike të komunave për të mbështetur sektorët më të dobët të qeverisjes. Edhe pse fusha e kanalizimit mbetet në nivel jo të kënaqshëm (36.51%), komunat për çdo vit janë duke implementuar projekte të zgjerimit të rrjetit të kanalizimit, por ka edhe projekte të nisura për ndërtim të impianteve. Pavarësisht kostos, investimet në këtë fushë duhet të jenë prioritet i vazhdueshëm, marrë parasysh rëndësinë e evitimit të faktorëve ndotës të ujit dhe ambientit në përgjithësi. Po ashtu, 46.76% e performancës në infrastrukturën rrugore tregon për nevojën për investime të mëtejme në këtë fushë. Sipas të dhënave të komunave rreth 71.83% e rrugëve lokale janë të shtruara me asfalt, për çfarë duhet që të punohet edhe më tutje për zgjerimin e infrastrukturës rrugore nëpër të gjitha vendbanimet e komunave. Për më tepër, rrugët duhet të jenë të kompletuara me infrastrukturë përcjellëse, gjegjësisht trotuare (aktualisht 9.15%) dhe ndriçim publik (15.03%). Përkundër faktit që në nivel të përgjithshëm të komunave vlerësohet të ketë hapësira të mjaftueshme për nxënës, nevoja për krijim të hapësirave shkollore shtesë është më e shprehur sidomos në zonat urbane. Njëherësh, kompletimi i shkollave me infrastrukturë, pajisje dhe mjete mësimore është i domosdoshëm, marrë parasysh se vetëm 49.26% e shkollave në nivel vendi, i plotësojnë standardet e kërkuara, përfshirë pajisjet apo kabinetet e nevojshme të TIK.

2. Përmbledhje e performances sipas komunave

Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale është një platformë e gjerë për mbledhjen, sistemimin, analizimin dhe raportimin e të dhënave të komunave në fusha të ndryshme të kompetencave vetanake të komunave. Matja e performancës së komunave ka ndikim të shumanshëm, e sidomos në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve. Studimet e bëra nga Organizata për Bashkërendim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) për reformat e shërbimit civil në 29 vende të ndryshme të botës, është parë se menaxhimi i performancës është faktori kryesor në shumë raste, veçanërisht në arritjen e objektivave të institucioneve. Për më shumë matja dhe vlerësimi i performancës i ndihmon komunat në përvetësimin e përvojave brenda komunale por edhe ndërmjet komunave duke e krahasuar punën e tyre prej vitit në vit dhe duke krijuar mundësinë e përmirësimit të punës së tyre.

Vlerësim i këtij viti ka pasur në fokus pasqyrimin e të arriturave për 38 komuna. Kërkesës për raportim i janë përgjigjur 36 komuna, me përjashtim të Komunës së Mamushës dhe Dragashit të cilat nuk kanë dorëzuar formularët e raportimit. Rangimi i komunave është bërë duke marrë parasysh nivelin e të arriturave sipas treguesve. Kjo për shkak se vlerësimi sipas treguesve

është konsideruar të jetë më objektiv për shkak të peshës që kanë, i ndikuar nga volumi i tyre brenda fushës së caktuar.

Për dallim nga periudha paraprake, në përgjithësi nuk vërehen ndryshime të komunave sipas performancës së arritur. Mesatarja e përgjithshme e komunave sipas treguesve është 61.16%. 22 komuna kanë arritur performancë mbi mesataren e përgjithshme, derisa 13 komuna janë nën mesataren.

Në vijim është paraqitur figura e radhitjes së komunave sipas performancës së treguesve:




Figure 4 Përqindja e arritur e komunave në 119 tregues

Sipas përqindjeve të prezantuara në figurën 3, vërejmë se komuna me performancën më të lartë është Glllogoci me 77.04%, pasuar nga Hani i Elezit me 75.78% dhe Rahoveci me 75.20%. Duhet theksuar se me rishikimin e treguesve për këtë vit raportues, performanca e shumë

treguesve të shërbimeve matet për kokë banori në komunë, apo për kilometër katrorë të komunës përkatëse.




Figure 5 Kategorizimi i komunave sipas nivelit të performancës së treguesve

Figura e mësipërme tregon për 13 komuna me performancë të lartë prej 66-80%, 18 komuna me performancë të mesme në mes 40-66%, 2 komuna me performancë të ulët 20-40% dhe 3 komuna me performancë më ulët se 20%. Referuar në karakteristikat e komunave, me arritje të lartë kryesisht dominojnë komunat e mesme.

Përkritazi me treguesit e përdorur, në total janë 8 tregues me performancë mbi 90%, si vijon:

- 1) Kërkesa të shqyrtuara administrative gjatë vitit (92.66%);
- 2) Suspendimi i zyrtarëve komunal në raport me aktakuzat e ngritura ndaj tyre (93.06%).
- 3) Dëgjimet Publike për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe buxhetin komunal (90.51%);
- 4) Plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs plotësues (90.47%);
- 5) Respektimi i procedurave ligjore për zgjedhjen e stafit drejtues të shkollave (drejtorëve dhe zv.drejtorëve) (91.11%);
- 6) Parandalimi i braktisjes së shkollimit nga nxënësit (97.17%) etj.

Tregues të tjerë në mes 80-90% të performancës janë:

- 1) Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave (87.77%);
- 2) Miratimi me kohë i buxhetit vjetor të komunës në Kuvendin Komunal (88.61%);
- 3) Niveli i qasjes së qytetarëve në dokumentet publike (87.31%);
- 4) Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore (88.19%),
- 6) Kërkesat e shqyrtuara për leje ndërtimi (85.55%),
- 7) Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar (85.34%).

Krahas tyre, tregues të papërbushur plotësisht apo në përqindje shumë të ulët janë:

- 1) Publikimi i raporteve të rezultateve të konsultimeve publike (0%)⁶;
- 2) Çerdhe dhe kopshte në zona rurale për 10000 banorë (1%);
- 3) Rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave (5.89%);

Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale (6.40%); Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive (12.17%). (Shih shtojcën 1).

⁶ Referuar nenit 17 të U.A. Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna

Nr. I Treguesëve	%
17.3.7	97%
18.3.2	95%
17.3.2	95%
17.3.8	94%
17.3.3	94%
3.4.2	93%
1.1.1	93%
17.2.6	91%
3.1.4	91%
17.2.5	90%
3.2.1	89%
1.1.2	88%
14.2.1	88%
17.2.4	88%
2.1.2	87%
6.1.2	86%
7.2.1	86%
4.2.2	85%
3.2.2	85%
3.5.2	84%
3.1.1	83%
17.2.1	83%
16.1.1	81%
17.3.6	79%
5.2.1	79%
14.1.1	78%
2.2.1	78%
3.3.1	78%
2.1.4	77%
15.1.2	76%
8.1.3	75%
3.2.4	75%
13.1.1	75%
17.3.5	75%
12.1.2	74%
7.2.2	74%
14.2.2	73%
3.5.1	73%
3.3.2	73%
12.1.1	72%
9.1.1	72%
18.1.1	71%
13.1.2	71%
2.1.3	71%
19.1.3	70%
2.2.2	70%
14.1.2	70%

**E lartë
(70-100%)**

48

Nr. I Treguesëve	%
7.2.3	70%
18.2.1	70%
6.1.1	68%
18.3.3	68%
5.1.1	68%
8.1.2	67%
3.1.3	67%
16.2.4	67%
10.1.1	67%
9.2.5	66%
17.2.2	66%
10.1.2	65%
3.1.8	65%
16.1.4	65%
9.1.3	65%
2.1.5	65%
15.1.1	64%
17.1.5	64%
3.2.6	62%
10.1.3	60%
4.2.1	60%
19.1.2	60%
17.3.4	60%
4.1.2	59%
2.1.1	59%
16.1.2	59%
17.1.3	58%
3.1.7	58%
17.1.6	58%
5.2.2	57%
15.1.3	57%
11.1.3	56%
19.1.1	56%
9.1.2	55%
3.1.6	54%
3.1.2	54%
9.2.3	53%
19.1.4	52%
16.2.1	51%
16.1.3	51%
17.1.4	51%
11.1.4	50%
14.3.1	50%
3.5.3	50%
3.2.3	50%
16.2.3	47%
17.1.2	42%

**E mesme
(40-70%)**

47

KATEGORIZIMI I TREGUESËVE

■ E lartë (70-100%) ■ E mesme (40-70%)
■ E ulët (20-40%) ■ Shume e ulët (0-20%)




Figure 6 Kategorizimi i treguesëve sipas nivelit të performancës

Performanca maksimale
për tregues

97%

Nr. I Treguesëve	%
18.3.1	37%
18.1.2	36%
16.2.2	36%
3.2.5	32%
1.1.4	31%
3.3.3	30%
3.4.1	28%
11.1.1	26%
4.1.1	23%

**E ulët
(20-40%)**

9

Nr. I Treguesëve	%
11.1.2	15%
9.2.2	15%
7.1.1	14%
16.3.2	12%
8.1.1	12%
16.3.1	12%
9.2.1	9%
17.2.3	7%
16.1.5	6%
18.2.2	6%
9.2.4	6%
17.3.1	1%
17.1.1	1%
3.1.5	0%
13.2.1	0%

**Shumë e ulët
(0-20%)**

15

KAPITULLI II

Analizë e treguesve sipas fushave

Fusha 1: Shërbimet Publike Administrative

Kjo fushë përbëhet nga katër tregues, që përfshin një tregues të shtuar për herë të parë. Fusha përfshinë shërbimet publike administrative (SHPA) dhe efikasitetin e shqyrtimit të kërkesave të qytetarëve, personave fizik dhe juridik, nga organet e komunës për çështjet që lidhen me kompetencat e tyre dhe të cilat kalojnë nëpërmjet Qendrës për Shërbimin e Qytetarëve në Komunë. Njëkohësisht, kjo fushë matë gatishmërinë e komunave për të ofruar shërbime administrative në formën online apo përmes e-kioskut.

Krahasuar me 19 fushat e tjera, kjo fushë radhitet e katërta për nga performanca, me nivel të përgjithshëm prej 70.47%, krahasuar me 92.6% sa ishte në vitin 2018.

Shërbimet Administrative - % sipas treguesve




Figure 7 Treguesit e performancës në fushën e shërbimeve administrative

Të dhënat tregojnë se komunat në masë të madhe kanë i shqyrtuar kërkesat administrative të cilat u janë parashtruar. Janë rreth 2,254,947 milion kërkesa administrative që komunat i kanë pranuar gjatë vitit 2019, nga të cilat janë shqyrtuar 2,158,438 kërkesa. Mesatarja e trajtimit të kërkesave për komunë është 42612.5 kërkesa. Këtu përfshihen kërkesat për leje të ndryshme komunale, dokumentet e gjendjes civile, kërkesat për qasje në informata, kërkesat qytetare për financim dhe adresim në organet përgjegjëse të komunës. Figura 4 tregon se kërkesat e parashtruara janë shqyrtuar në vlerën prej 92.66%, ndërsa 88.19% e tyre janë shqyrtuar brenda afateve ligjore.

Referuar performancës sipas komunave në këtë fushë, përqindja më e lartë në përmbushjen e treguesve është në Komunën e Rahovecit me 96.50%, kurse më e ulëta në Komunën e Shtërpcës në 29.35%. Krahas tyre në këtë fushë nuk kanë raportuar Komuna e Zubin Potokut dhe Mitrovicës Veriore, për këtë arsye performanca i'u është llogaritur në 0%.

% e ofrimit të shërbimeve administrative sipas komunave




Figure 8 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e shërbimeve administrative

Megjithatë, duhet theksuar se për vitin raportues është shtuar treguesi për ofrimin e shërbimeve administrative online dhe kjo ka rezultuar me zbritje të performancës së përgjithshme në këtë fushë.

Treguesit e shërbimeve elektronike japin të dhëna për nivel jo të lartë të zhvillimit të procedurave administrative në këtë formë. Megjithatë, vërehet se komunat kanë filluar të aplikojnë platforma për ofrimin e shërbimeve online, një pjesë e të cilave janë të integruara në ueb-faqet zyrtare të tyre, apo përmes e-kiosqeve. Sipas të dhënave të SMPK-së të cilat matin nivelin e parashtrimit të kërkesave online për 10 certifikata, leje apo fatura, niveli i ofrimit të shërbimeve në këtë formë është 30.56%. Kjo formë e ofrimit të shërbimeve zvogëlon koston e komunës në trajtimin e tyre, rrit efikasitetin në trajtimin me kohë të tyre dhe mundëson që shërbimet administrative të ofrohen pa pasur nevojë të ketë kontakt të drejtpërdrejt me zyrtarët komunal. Ofrimi i shërbimeve administrative online duhet të fillohet nga komunat që ende nuk kanë marrë iniciativa të tilla, ndërsa duhet të zgjerohet në komuna që kanë filluar të ofrojnë disa certifikata të gjendjes familjare apo fatura për shërbime komunale.

Fusha 2 – Transparenca Komunale

Edhe pse kjo fushë ka qenë më herët me 16 tregues, në vitin 2019 është ri-strukturuar duke u ndarë në dy pjesë: Transparenca komunale dhe Përgjegjshmëri komunale. Tani kjo fushë ka shtatë tregues që synojnë të arrijnë rezultate në sigurimin e qasjes në të dhëna komunale, pjesëmarrjen në mbledhjet e kuvendeve, rritjes së standardeve të informacionit përmes ueb-faqeve, transparençën buxhetore dhe prokurimin publik.

Performanca e përgjithshme e arritur në fushën e transparençës është 72.93%, për dallim nga viti paraprak ku ishte 76.2%. Sa u përket performancës sipas treguesëve, përqindja më e lartë është në lejimin e qasjes së qytetarëve në dokumentet zyrtare shprehur me 87.31%.

% e treguesve të transparencës




Figure 9 Treguesit e performancës në fushën e transparencës

Nga figura e mësipërme shihet se treguesi për transmetimin online të mbledhjeve të kuvendit del në nivel 59.13%, gjë që ndikon edhe në uljen e tërësisë së performancës në këtë fushë. Tetë kriteret për ueb-faqe komunale del të jenë përbushur në masën 70.83%, ndërsa, aktet e kuvendit të komunës publikohen në masë 77.37%. Të dhënat tregojnë për trend pozitiv në publikimin e akteve me karakter të përgjithshëm të aprovuara nga kryetarët e komunave.

Po ashtu, komunat kryesisht janë transparente në publikimin e buxhetit të komunës si dhe raporteve të shpenzimeve, megjithatë vërehet jo konsistencë në formatin e buxhetit dhe raporteve financiare që publikohen nga komunat. Planin vjetor të prokurimit publik del ta kenë pothuajse të gjitha komunat ndërsa vetëm tetë prej tyre nuk kanë publikuar ndonjë raport për realizimin e këtij plani.

% e të arriturave të komunave në fushën e transparencës




Figure 10 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e transparencës

Figura e mësipërme tregon për 16 komuna të cilat kanë treguar performancë në mes 90-100% në fushën e transparencës, prej të cilave: Vushtrri (100%), Kaçaniku (100%), Glllogoc (100%), Peja (99.89%), Rahoveci (98.95%), Lipjan (98.75%), Ferizaj (98.13%) etj. Janë 4 komuna të cilat akoma nuk shfrytëzojnë ueb-faqet zyrtare si burim zyrtar të informacionit.

Fusha 3 – Përgjegjshmëria Komunale

Përgjegjshmëria komunale është inkadruar si fushë e re në SMPK-së dhe ka gjithsej 22 tregues. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 62.64%. Në kuadër të kësaj fushe, vërejmë performancë të lartë të komunave në ndërmarrjen e veprimeve ligjore për suspendimin e zyrtarëve për të cilët ka pasur aktakuzë në lidhje me veprat për shpërdorim detyrës zyrtare. Sipas të dhënave aktakuza për vepra të tilla penale ka pasur për 28 zyrtarë në 9 komuna, prej të cilëve 13 janë raportuar të jenë suspenduar. Në përqindjen prej 93.06% në nivel të këtij treguesi ka ndikuar numri i madh i komunave në të cilat nuk kanë pasur raste me aktakuza për zyrtarët publik, që sipas SMPK-së konsiderohet performancë pozitive. Komunitat kanë treguar performancë pozitive edhe në diskutimin e projektbuxheteve dhe kornizës afatmesme të shpenzimeve. Sipas të dhënave në 36 komuna janë mbajtur 280 takime me qytetarë për projektbuxhetin, apo mesatarisht 8 takime për komunë. Në vijim është paraqitur lista e treguesve në këtë fushë sipas përqindjes:

Treguesit e përgjegjshmërisë komunale në %



Figure 11 Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmërisë komunale

Nga të dhënat e figurës së mësipërme del që pjesa më e madhe e komunave nuk e kanë të hartuar dhe si rrjedhojë nuk e kanë parashtruar në kuvend komunal planin vjetor të integritetit. Po ashtu është parë nivel i ulët i diskutimit të raportit të Auditorit të Brendshëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve. Pavarësisht obligimit juridik të komunave për diskutimin e raportit të performancës për vitin paraprak në kuvendin e komunës, dispozita e rregullores përkatëse është respektuar në masën prej 50%. Ndërsa akoma nuk ka filluar të zbatohet dispozita e re e udhëzimit administrativ për standardet minimale të konsultimit publik

në nivel lokal për të publikuar raportet me rezultatet e proceseve të konsultimeve publike, me anë të së cilave qytetarët do të merrnin përgjigje për adresimin e propozimeve të tyre nga organet përgjegjëse të komunës. Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike del mjaft e ulët edhe përkundër të standardit të SMPK-së të 3% të popullsisë së komunës, i cili është përmbushur në shkallën 53.79%. Komunat kanë raportuar për 27423 qytetarë të kenë marrë pjesë në proceset e konsultimeve publike, apo 760 qytetarë janë konsultuar për komunë. Sigurisht që ka disa komuna si Suhareka, Vitia, Skenderaj, Obiliq dhe Pejë, ku pjesëmarrja është mjaft e shprehur krahasuar me popullsinë e këtyre komunave. Sa i përket nivelit të zbatimit të planit të prokurimit, bazuar në shumën e shpenzuar kundrejt shumës së planifikuar, performanca rezulton në masën 77.64%.




Figure 12 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e përgjegjshmërisë

Performancën më të lartë në indikatorët e kësaj fushe e ka arritur komuna e Lipjanit dhe Kaçanikut. Po ashtu në nivel të lartë qëndrojnë edhe Komuna e Glllogocit, Hanit të Elezit dhe Rahovecit. Ndryshe nga to, më ulët qëndrojnë komunat: Mitrovicë Veriore, Shtërpçë, Zubin Potok dhe Novobërdë. Në nivelin jo të mirë të performancë në këtë fushë, ka ndikuar edhe mosraportimi i të gjitha të dhënave për tregues nga komunat në fjalë.

Fusha 4 – Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare

Kjo fushë prej dy rezultateve dhe katër treguesve mbulon përfaqësimin e grupeve të ndryshme në punësim komunal, si dhe shërbimet sociale të grupeve më me nevojë në komuna. Në kuadër të punësimit treguesit masin nivelin e punësimit të personave me aftësi të veçanta në institucionet komunale, si dhe përqindjen e përfshirjes së komuniteteve joshumicë. Performanca të përgjithshme në këtë fushë prej 57.70%.

% e treguesve




Figure 13 Treguesit e performancës në fushën e Barazisë në Punësim, Shërbimeve Sociale dhe Familjare

Sipas të dhënave niveli i përmbushjes së kuotës për të punësuar me nevoja të veçanta është mjaft i ulët. Ligji Nr. 05L-051 për mbrojtje nga diskriminimi, përcakton se të gjithë janë të barabartë në punësim, ku punëdhënësit duhet të ndërmarrin masa të duhura që t'i mundësojnë personit me aftësi të kufizuara të ketë qasje, të marrë pjesë apo të avancohet në punësim, nëse kjo masë përbën ngarkesë joproporcionale për punëdhënësin. Po ashtu neni 12 i Ligjit Nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara kërkon që çdo institucion publik të ketë të punësuar një person me aftësi të kufizuara në çdo 50 punonjës (apo 2% e të punësuarve). Matja e këtij treguesi synon të sjell informata për përmbushjen e kushtit ligjor, kur kemi parasysh se shumica e institucioneve publike nuk kanë përmbushur këtë obligim. Sipas të dhënave të deklaruara nga komunat për numrin e të punësuarve në institucionet komunale nga totali prej 37310 të punësuar, 161 janë deklaruar të jenë me nevoja të veçanta, kurse 1757 nga radhët e komuniteteve joshumicë. Përmbushja e kërkesave të banimit social është në shkallën 60.28% dhe ka shumë pak familje që e lëshojnë banimin social.

% sipas komunave




Figure 14 Krahاسimi i performancës së komunave në fushën e Barazisë në Punësim, Shërbimeve Sociale dhe Familjare

Fusha 5 – Kulturë, Rini dhe Sport

Në kuadër të kësaj fushe maten aktivitetet komunale kulturore, rinore dhe sportive, si një nga kompetencat vetanake të komunave. Fusha mbulon edhe shërbimet e ofruara nga komunat që kanë të bëjnë me kulturën, rininë dhe sportin, përfshirë hapësirat sportive.

Fusha matë performancës duke e krahasuar me numrin e banorëve për arsye që të jetë më e balancuar ndaj komunave me shumë banorë dhe atyre me më pak banorë. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 67.99%.

% e treguesëve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit




Figure 15 Treguesit e performancës në fushën e kulturës

Standardi i SMPK-së për së paku një aktivitet të kulturës, rinisë dhe sportit për 100 banorë në komunë arrihet në masën prej 79.2%. Ndërsa hapësirë për aktivitete sportive për numër të banorëve arrihet në masën 68.2%. Sipas të dhënave në 33 komuna janë organizuar rreth 2300 aktivitete kulturore dhe sportive. Pjesëmarrja qytetare në këto aktivitete krahasuar me numrin e banorëve është 57.37%.

% e arritur e komunave




Figure 16 Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e kulturës

Fusha 6 – Menaxhimi i fatkeqësive

Kjo fushë matë planifikimin, organizimin dhe udhëheqjen e sistemit të organizuar të komunës për tu përgjigjur ndaj dukurive të shkaktuara nga fuqitë e pakontrolluara dhe nga fuqitë tjera. Fusha ka vetëm një rezultat dhe dy tregues, që kryesisht vlerësojnë realizimin e planit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore, si dhe nivelin e përgjigjeve të institucioneve komunale ndaj rasteve të paraqitura në këtë fushë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 77.19%.




Figure 17 Treguesit e performancës në fushën e menaxhimit të fatkeqësive

Sipas të dhënave, intervenimet e institucioneve komunale ndaj fatkeqësive del të jenë në nivel prej 85.90%. Shprehur në numër, në 33 komuna që kanë raportuar për këtë tregues, nga 12850 fatkeqësi të raportuara ekipet përgjegjëse komunale kanë intervenuar në 12556 prej tyre. Gjithashtu 68.48% e komunave rezultojnë të kenë pasur plan komunal për menaxhim të fatkeqësive si dhe raport për realizimin e planit. Për më tepër, nga 1755 veprime të parapara të 30 komunave që ofruan të dhëna në planet e tyre për menaxhimin e fatkeqësive, u realizuan 1599 veprime, apo 91%⁷. Vitin e kaluar performanca e përgjithshme e kësaj fushe ishte në 83.3%.




Figure 18 Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e menaxhimit të fatkeqësive natyrore dhe të tjera

⁷ Në vlerën e përgjithshme 68.48% ndikoi vlera 0% e llogariut për komunat të cilat nuk kanë ofruar të dhëna.

Fusha 7 – Planifikimi Hapësinor

Kjo fushë matë zhvillimin hapësinor komunal nëpërmjet instrumenteve të planifikimit hapësinor, por edhe nivelin e planifikimit të ndërtimeve komunale. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 45.24%.




Figure 19 Treguesit e performancës në fushën e planifikimit hapësinor

Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese të hollësishme është në shkallë prej 14.05%. Sa i përket lejeve ndërtimore, nga 5391 kërkesa të parashtruara për leje ndërtimi, nga komunat u shqyrtuan me kohë 4150 kërkesa apo 85.55%. Sipas të dhënave, ndërtesat e reja për të cilat u lëshuan leje ndërtimore, u inspektuan në shkallë prej 73.86%.




Figure 20 Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e planifikimit hapësinor

Fusha 8 – Hapësirat Publike

Kjo fushë matë hapësirat publike të cilat janë me interes për qytetarët, menaxhohen nga komunat dhe të cilat ndikojnë në cilësinë dhe standardin e jetesës së qytetarëve. Performanca e përgjithshme sipas të dhënave të ofruara nga komunat është 51.58%. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, komunat ndër të tjera janë kompetente për ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike.




Figure 21 Treguesit e performancës në fushën e hapësirave publike

Përpos nivelit të hapësirave të gjelbra për kokë banori, kjo fushë matë edhe sipërfaqen e hapësirave publike të cilat mirëmbahen rregullisht nga komunat, si dhe numrin e hapësirave publike të përcjella me ndriçim publik.




Figure 22 Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e hapësirave publike

Sipas të dhënave rreth 67.5% të hapësirave publike mirëmbahen rregullisht, ndërsa 75.4% të hapësirave publike janë të përcjella me ndriçim publik.

Fusha 9 – Infrastruktura Rrugore

Kjo fushë matë rrugët komunale dhe infrastrukturën përcjellëse që janë nën kompetencën e komunës. Fusha është plotësuar me tregues të ri për të nxitur përmirësimin e infrastrukturës rrugore me trotuare, ndriçim, shenjëzim si dhe shteg të biçikletave. Performanca e përgjithshme vlerësohet në shkallë prej 46.76%.

% e treguesve në fushën e Infrastrukturës rrugore



Figure 23 Treguesit e performancës në fushën infrastrukturës rrugore

Ajo çfarë e bënë performancën e përgjithshme të mos jetë aq e lartë, është përfshirja treguesit i ri për rrugët në zonat urbane me shtigje të biçikletave, që del të jetë në shkallën prej 5.89%, si dhe raporti në mes të rrugëve lokale me trotuare dhe ndriçim publik. Për më shumë, nga 2530.173 km rrugë të asfaltuara në zonat urbane të 29 komunave që kanë ofruar të dhëna, 142.57 km janë të përcjella me shtigje të biçikletave, apo 5.89%. Po ashtu, nga totali prej 57358.431 km rrugë në zonat urbane dhe rurale, 4865.133 km rrugë janë të pajisura me trotuare apo 9.15%, kurse me ndriçim publik janë raportuar 15.03% të rrugëve. Shtrimi dhe riasfaltimi i rrugëve është në prej 71.83% të planifikimit të përbushur në këtë tregues. Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale ka nevojë për përmirësim, pasi që mirëmbajtja verore është në shkallën 54.57% ndërsa mirëmbajtja dimërore 64.98%. Performanca e komunave në nivel të fushës është paraqitur si më poshtë:




Figure 24 Të dhënat krahasimore në mes të komunave

Fusha 10 – Transporti Publik

Kjo fushë matë ofrimin e transportit publik për qytetarët e komunës. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 64.13%.




Figure 25 Treguesit e performancës në fushën e transportit publik

Në kuadër të kësaj fushe vërejmë performancë mbi mesatare për të tre treguesit. Sipas të dhënave, Komunitat kanë realizuar Planin Komunal për Transport Publik në vlerën prej 66.55%. Krahas kësaj, 11 nga komunitet⁸ (të vogla dhe të mesme) nuk kanë dokumentuar se kanë hartuar një plan të tillë, në të kundërtën 18 komuna kanë realizuar planin në vlerë prej 100%.

Në treguesin “Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik”, 8 nga 38 komunitet e Kosovës nuk kanë raportuar në këtë tregues dhe mesatarja për 30 komuna arrin vlerën në 65.47%, kurse vendndalimet e shënjestuara për automjetet e transportit publik janë në nivelin 60.38%.

Në vijim është paraqitur performanca e fushës përqindje për secilën nga komunitet e Kosovës:




Figure 26 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e transportit publik

⁸ Fushë Kosovë, Graçanicë, Klllokot, Novo Bërdë, Partesh, Ranillug, Shtërpocë, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut.

Fusha 11 – Parkingjet Publike

Hapësirat për parkim publik janë vende në pronësi publike dhe private, me një numër të caktuar të vendeve të parkimit, të ndërtuara me standardet e kërkuara dhe të caktuara për parkimin e mjeteve motorike. Për më tepër, kjo fushë matë numrin e parkingjeve në komunë dhe numrin e vendparkimeve kundrejt veturave të regjistruara në komunë, po ashtu sa ka vende për taksi kundrejt numrit të taksive të licencuara dhe sa parkingje publike kanë vende të rezervuara për persona me nevoja të veçanta.

Performanca në nivel të fushës është 40.41%.




Figure 27 Treguesit e performancës në fushën e parkingjeve

Numri i parkingjeve në nivel të Kosovës për komunat të cilat kanë raportuar është 1437, me gjithsej 48 788 vendparkime, në raport me 460 725⁹ vetura sa janë të regjistruara në komunat që kanë raportuar. Krahësuar me numrin e automjeteve të regjistruara, komunat me vendparkime mbulojnë vetëm 15.22%. Shkalla e vendparkimeve të destinuar për makinat taksi të regjistruara në komuna është 55.62%. Sa i përket numrit të vendparkimeve për persona me aftësi të kufizuara, vetëm 50.40% e parkingjeve i kanë të shënuara vendet e tillë.

Në vijim është paraqitur arritjet e komunave në këtë fushë në përqindje.




Figure 28 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e parkingjeve publike

⁹ Komunat Shtërpce, Zubin Potok, Zveçan; Leposaviq, Mitrovicë e Veriut dhe Klina nuk kanë ofruar informat për numrin e veturave të regjistruara në komunë.

Fusha 12 - Uji i pijshëm

Kjo fushë matë sigurimin apo furnizimin e qytetarëve dhe bizneseve me ujë të pijshëm si dhe realizimin e projekteve komunale për ujë të pijshëm. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 73.10%.




Figure 29 Treguesit e performancës në fushën e ujit të pijshëm në nivel vendi

Në vitin paraprak (2018), performancë e përgjithshme ishte 76.4%. Të dhënat flasin se komunat kanë realizuar planin për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit në masë prej 72.33%.




Figura 30 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e ujit të pijshëm

Sipas figurës së mësipërme, vërejmë se 4 komuna kanë raportuar për shtrirje të rrjetit të ujit të pijshëm në 100% te ekonomitë familjare, institucionet publike dhe ekonomitë biznesore.

Prej 376550 ekonomive familjare¹⁰ sa janë raportuar nga komunat në nivel të Kosovës, 343619 prej tyre kanë qasje në sistemin e ujit të pijes apo 91.25%. Kurse sa i përket ekonomive biznesore, nga 45462 vetëm 28901 kanë qasje në këtë sistem apo 63.57%. Gjendje relativisht më e mirë është në institucionet komunale, ku 2080 nga 2408 sa janë raportuar nga komunat, të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm janë 86.38%. Përqindja e përgjithshme në këtë tregues është 73.87%.

¹⁰ Komunat e Zubin Potokut dhe Klokotit nuk kanë ofruar të dhëna për numrin e ekonomive familjare në komunë

Fusha 13 - Kanalizimi

Kjo fushë matë përfshirjen e ekonomive familjare, bizneseve dhe institucioneve në sistemin e kanalizimit si dhe realizimin e projekteve komunale për rrjet të kanalizimit. Po ashtu, ky tregues matë edhe përfshirjen e vendbanimeve të komunës në rrjetin për trajtimin e ujërave të zeza si një nga faktorët mjaft të rëndësishëm në ambient, kushte të jetesës dhe shëndetin publik. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 36.51%.




Figure 31 Treguesit e performancës në fushën e kanalizimit

Sipas të dhënave rreth 71.42% e ekonomive familjare, institucioneve publike dhe bizneseve janë deklaruar të përfshira në sistemin e kanalizimit, ndërkohë zbatimi i aktiviteteve nga plani për ndërtim dhe mirëmbajtje të sistemit të kanalizimit është raportuar të jetë 74.64%.

Për treguesin e trajtimit të ujërave të zeza gjatë verifikimit të të dhënave është konstatuar se nuk janë ofruar të dhëna të sakta, duke bërë që të dhënat të mos konsiderohen të vlefshme, megjithëse vlera 0% reflekton në përqindjen totale të komunave. Pavlefshmëria e të dhënave ka ndikuar në nivelin e performancës tejte të ulët të kësaj fushe, edhe pse në disa komuna është raportuar se janë vënë në funksion sisteme për trajtimin e ujërave të zeza, apo impiante.




Figure 32 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e kanalizimit

Fusha 14 – Menaxhimi i Mbeturinave

Kjo fushë matë mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave në komunë si dhe grumbullimin e të hyrave nga faturat e lëshuara për menaxhimin e mbeturinave. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 69.25%.

% sipas treguesëve




Figure 33 Treguesit e performancës në fushën e menaxhimit të mbeturinave

Sasia e madhe e deponimit të mbeturinave në kilogram për kokë banori, potencialisht tregon performancë më të lartë, por jo gjithëherë. Sa më shumë deponim të mbeturinave, është supozim që tregon për më pak mbeturina në mjediset jetësore, por kjo rëndom nuk ndodhë, për shkak se ende nuk grumbullohen dhe nuk deponohen të gjitha mbeturinat e prodhuara nga ekonomitë përkatëse. Të dhënat e raportuara të vitit 2019 nga komunat tregojnë se ekonomitë familjare me qasje në grumbullim të mbeturinave janë në shkallën prej 70.10%. Megjithatë, Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) në Raportin për Menaxhimin e Mbeturinave i publikuar më 2018, tregon se mbulimi e ekonomive familjare me këtë shërbim është në shkallën prej 57.7%. Shkalla e inkasimit të mjeteve për grumbullimin e mbeturinave del të jetë në masën 73.35%, ngjashëm me raportin e AMMK-së për vitin 2018. Sasia e gjenerimit të mbeturinave në Bashkimin Evropian është 492 kg për kokë banori gjatë vitit 2018¹¹, që krahasuar me sasinë e deponimit të mbeturinave në Kosovë, është vlerësuar të jetë arritur në shkallën prej 50.35%.

% sipas komunave





Figure 34 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën menaxhimit të mbeturinave

¹¹ https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Municipal_waste_statistics

Fusha 15 – Mbrojtja e Mjedisit

Kjo fushë matë veprimet e komunës përkatëse për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe jetësor (urban dhe rural) nga dëmtimi, degradimi apo ndotja si pasojë e veprimtarisë njerëzore ose të ndikimit natyror. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 65.64%. Vërehet një ngritje prej 2.1% krahasuar me vitin paraprak që kishte një performancë të përgjithshme prej 66.1%.



Realizimi i planit të veprimit të mjedis del të jetë arritur në masën prej 64.49%. Lejet mjedisore të lëshuar ishin në shkallën 75.57% ndërsa ndërtesat e reja që kanë zbatuar lejet mjedisore komunale del në shkallë mjaftë të ulët prej 56.85%.




Figure 35 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën mbrojtjes së mjedisit

Fusha 16 – Përfaqësimi Gjinor

Edhe pse fushë e re në SMPK, tregues për përfaqësim gjinor ka pasur edhe në matjet e mëparshme. Mirëpo tani përfaqësimi gjinor matet më gjerësisht në këtë fushë duke përfshirë qasjen e të dy gjinive në programet për zhvillim social, ekonomik, si dhe në aktiviteteve komunale. Po ashtu, treguesit matin shkallën e përfaqësimit të të dy gjinive në institucionet lokale, trupat e kuvendeve komunale etj. Me gjithë progresin e komunave ndër vite në sigurimin e përfaqësimit të barabartë në trupat e kuvendeve dhe në komisionet komunale, të dhënat për treguesit e caktuar minimizojnë përqindjen në këtë fushë duke e bërë atë mjaft të ulët, 38.24%. Në vijim, është paraqitur figura e përfaqësimit gjinor sipas treguesve:




Figure 36 % e treguesve në fushën e përfaqësimit të barabartë gjinor¹²

Sipas të dhënave të raportuara nga 36 komuna, nga totali prej 37,310 e të punësuarve në institucione komunale, 17,660 prej tyre janë gra, apo 80.66% e kriterit ligjor 50x50. Po ashtu, 23 komuna dokumentuan të hartuar planin për barazi gjinore, derisa 13 prej tyre nuk e kanë dëshmuar të hartuar këtë plan.¹³ Sa i përket pozitave politike, nga 420 pozita në kuadër të ekzekutivit komunal, 119 janë gra, apo 50.95% e kriterit ligjor në 36 komuna. Përqindja e përfaqësimit në trupat e kuvendeve komunale është 65% e kriterit. Sipas të dhënave të përfaqësimit të grave në pozitat udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive, nga 1663 pozita udhëheqëse, 516 prej tyre udhëhiqen nga gratë, apo 59.02 % të përmbushjes së kriterit ligjor. Barazia gjinore është mjaftë e lartë në institucione komunale ku mesatarisht 80.66% e komunave përmbushin standardin e kërkuar.

Përfaqësimi gjinor në këshillat lokale është tejet i ulët dhe shumica dërmuese e komunave nuk kanë asnjë grua që udhëheq këto këshilla. Kjo edhe duke marrë për bazë që gati gjysma e

¹² Niveli 50% konsiderohet arritje e plotë e përfaqësimit duke u bazuar në Ligjin për Barazi Gjinore

¹³ Gjilan, Graçanicë, Hani I Elezit, Klinë, Novobërdë, Podujevë, Ranillug, Shtërpçë, Viti, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq.

komunave nuk kanë kështilla lokal funksional siç tregohet në fushë e tretë. Përfaqësimi gjinor tek emrat e rrugëve komunale është tejet i ulët po ashtu edhe regjistrimi i pronave në emër të një grua apo dy gjinive (bashkëshortë apo vëllezër dhe motra).

% e arritur e komunave - Përfaqësimi gjinor




Figure 37 Krahasimet sipas komunave në fushën e barazisë gjinore

Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor del se bëhet nga pak mbi gjysmën e komunave. Megjithatë, ka nevojë mjaft të madhe për trajnim në këtë drejtim si dhe për vullnet të komunave që të kuptojnë rëndësinë e kësaj çështje. Barazia gjinor në buxhetim për subvencione dhe program të komunës është në shkallë mjaftë të ulët prej 36.33% dhe kjo duhet të ngritet në nivel të barazisë prej 50%.

Fusha 17 - Arsimi Parauniversitar

Kjo është fushë e re, për herë të parë e zbatuar në raportimin e vitit 2019, e përbërë prej 3 rezultateve dhe 20 treguesve. Ky tregues synon rezultate në hapësira për çerdhe dhe shkolla të pajisura me kabinete për internet, masa të efikasitetit të energjisë, rekrutimin e personelit arsimor, licencimin e mësimeve, mjetet e konkretizimit, pajisjet e shkollave me mjete mësimore, kabinete të TIK-ut, si dhe kushtet e sigurisë në shkollë. Kjo fushë ka performancën e përgjithshme në nivel prej 66.60%. Në përgjithësi, në treguesit e arsimit të dhënat e raportuara nga komunat nuk kanë qenë të plota, kështu që përqindjet e fituara mund të paraqesin një vlerë relative të saktësisë.

Nga totali prej 115 çerdheve publike të 16 komunave sa kanë raportuar, në 15 prej tyre janë raportuar të jenë 38 çerdhe në zona rurale¹⁴. Krahasuar me numrin e fëmijëve që janë raportuar se jetojnë në 22 komuna të cilat kanë raportuar, 4.91% e fëmijëve të moshës deri në 3 vjeç vijnë në kopshtin¹⁵, prej tyre 1.43% në zona rurale. 57.53% të shkollave plotësojnë kushtet me infrastrukturë, pajisje dhe mjete, 50.89% prej tyre kanë masa të efikasitetit të energjisë si dhe 58.48% të shkollave fillore del të jenë të pajisura me kabinete të TIK-ut. Krahas kësaj, 64.19% e shkollave të 34 komunave që kanë raportuar janë të pajisura me masa të

¹⁴ Komunat që kanë deklaruar çerdhe në zonat rurale janë: Deçan (1), Gjilan (1), Glllogoc (1), Graçanica (3), Kamenicë (1), Klinë (1), Klllokot (3), Junik (1), Prishtinë (2), Rahovec (1), Ranillug (5), Shtërpçë (2), Skenderaj (1), Suharekë (2), Zubin Potok (4),

sigurisë, ku përfshihen rrethojat dhe kamerat e sigurisë. Përkitazi me hapësirat shkollore, mesatarja në nivel vendi është 11.49m² për kokë nxënësi në zonat rurale dhe urbane.

Në 31 komuna që kanë raportuar, niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësimdhënës, apo 1 mësues për 26 nxënës, është në shkallën 67.46%. Mësimdhënës të licencuar del të jenë 83.29%. Sa i përket regjistrimit të nxënësve dhe shkallës së përfshirjes së tyre në klasën e parë, komunat nuk kanë ofruar të dhëna të sakta për këtë tregues. Komunat kanë raportuar për gjithsej 93.97% të realizimit të planit të orëve mësimore.

% sipas treguesve




Figure 38 % e treguesve në fushën e arsimit parauniversitar në nivel vendi

Rezultatet për testin e arritshmërisë dhe kalueshmërisë në maturën kombëtare janë nxjerrë sipas raportimit të 28 komunave.

Plotësimi i buxhetit për arsim nga të hyrat vetanake është 7.04% e cila është e përafërt me shkallën e buxhetit për shëndetësi primare nga të hyrat vetanake.




Figure 39 Krahasimet sipas komunave në fushën e arsimit parauniversitar

Fusha 18 – Kujdesi Primar Shëndetësor

Edhe kjo është fushë e re në kuadër të SMPK-së dhe është e përbërë prej 7 treguesve. Kjo fushë matë infrastrukturën dhe hapësirat e destinuar për shëndetësinë primare, resurset dhe personelin e mjaftueshëm, si dhe ofrimin e shërbimeve nga niveli komunal. Sipas të dhënave të raportuara nga komunave, kjo fushë ka nivel të ulët të performancës në përgjithësi, apo 51.19%. Në vijim është paraqitur figura me % e performancës sipas treguesve në këtë fushë:




Figure 40 % e treguesve në fushën e shëndetësisë primare

Nga totali i fëmijëve të cilët janë në moshën e imunizimit, janë deklaruar të imunizuar 94.87% e tyre.

36.40% nga objektet e kujdesit primar shëndetësor plotësojnë kriteret me pajisje dhe shërbime laboratorike sipas udhëzimit administrativ të ministrisë së shëndetësisë Nr. 08/2017 MSH.

Ndërsa, raporti mjek familjar si dhe dy infermierë për 2000 banorë sipas standardit plotësohet në nivelin 69.61%. Në 32 komuna që kanë raportuar për numrin e vizitave në qendrat primare shëndetësore, të dhënat tregojnë për 6,517,850 vizita mjekësore të pacientëve këto institucione, apo mesatarisht 3.79 vizita për banorë brenda vitit. 5.97% e buxhetit total për shëndetësinë primare mbulohet nga komunat. 67.96% e institucioneve të kujdesit primarë shëndetësorë ofrojnë shërbime specifike për gra dhe fëmijë¹⁶.

% sipas komunave




Figure 41 Krahasset sipas komunave në fushën e shëndetësisë primare

Fusha 19 – Zhvillimi Ekonomik Lokal

Kjo është fushë e re dhe për herë të parë e zbatuar në këtë cikël raportimi. Fusha është e përbërë prej 1 rezultati dhe 4 treguesve. Kjo fushë matë aktivitetet e planifikuara dhe të zbatuara për zhvillimin e aktivitetit ekonomik në nivel lokal duke mobilizuar pronat komunale, dhe përditësim i rregullt i regjistrit të tatimpaguesve si dhe shkallë e lartë e inkasimit të tatimit në prone. Kjo fushë ka performancën e përgjithshme prej 59.35%.

Treguesit në %




Figure 42 % e treguesve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal

¹⁶ Për shkak se ky shërbim nuk është lejuar në të gjitha komunat nga ministria e shëndetësisë, nuk është llogaritur në performancën e përgjithshme të komunave

Mbi gjysma e komunave kanë raportuar për hartimin e planeve për zhvillim ekonomik lokal. Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale është në shkallë 59.72%. Ndërsa, azhurnimi i regjistrit për tatim në prone (standardi prej 20%) përmbushet në shkallë prej 70.20%, derisa shkalla e mbledhjes së tatimit në prone është 51.91%.




Figure 43 Krahasset sipas komunave në fushën e arsimit parauniversitar

Konkluzione dhe rekomandime

Vlerësimi i performancës komunale për vitin 2019 nxjerr të gjetura të shumta për 19 fusha të kompetencave komunale. Përfundimet e këtij raporti theksojnë një numër të madh të çështjeve, të cilat duhet të merren parasysh dhe trajtohen me prioritet nga organet e pushtetit lokal. Në këtë pjesë të raportit, janë veçuar disa nga konkluzionet dhe rekomandimet me peshë më të madhe në avancimin e shërbimeve komunale. Raporti nxjerr përfundimet se:

1. Vlerësimi i performancës së komunave për vitin 2019 është bërë për 36 komuna të cilat kanë raportuar. Këtij procesi nuk i janë përgjigjur Komuna e Mamushës dhe Dragashit. Disa nga të dhënat e raportuara nga komunat me shumicë serbe, në fushën e arsimit dhe shëndetësisë, të cilat nuk korresponduan me ofrimin e shërbimeve sipas legjislacionit pozitiv të Republikës së Kosovës, janë shpallur nule dhe u aplikua vlera 0% e performancës. Matja dhe vlerësimi i performancës është obligim ligjor i të gjitha komunave, të cilat duhet t'i përgjigjen kërkesave për informata konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullores për Sistemin e Menaxhimit të Performancës komunale.
2. Përkundër gjendjes së pandemisë, cilësia e raportimit ka qenë relativisht e mirë. Komunat duhet t'i kushtojnë vëmendje të gjitha të dhënave të prezantuara për raportim, në mënyrë që vlerat e fituara të paraqesin vlerësimin sa më objektiv të performancës për çdo tregues.
3. Dokumentimi i të dhënave është kusht i domosdoshëm. Gjatë përgatitjes së të dhënave dhe informatave, komunat duhet të përgatisin dosjen për secilën fushë. Procesi i sigurimit të cilësisë ka evidentuar një numër të të dhënave të pasakta, të cilat në shumë raste janë shpallë të pavlefshme, përveç atëherë kur është bërë dokumentimi i tyre.
4. Cilësia e raportimit duhet të rritet në të ardhmen, ashtu që raportimi të jetë i drejtë, i saktë, objektiv dhe të paraqes gjendjen sa më reale të performancës së komunave.
5. Të dhënat e performancës konstatojnë epërsinë e fushës së menaxhimit të fatkeqësive në raport me fushat e tjera. Transparenca komunale shënon vendin e dytë, megjithëse treguesi për pasqyrimin e rezultateve të konsultimeve publike duhet të trajtohet seriozisht nga autoritetet lokale. Komunat duhet të fillojnë në zbatimin e standardeve të reja minimale për konsultimin publik. Raportet e proceseve të konsultimeve publike duhet të përpilohen për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në politikbërje dhe marrjen e opinionit të tyre për çështje publike.
6. Po ashtu ka nevojë për standardizim të përdorimit të ueb-faqeve zyrtare të komunave. Informatat, raportet dhe dokumentet janë vendosur në meny jo të përshtatshme, duke e bërë shumë të vështirë qasjen në informata. Publikimi i dokumenteve duhet të bëhet sipas menyve (aplikacioneve) specifike për materiale të caktuara.
7. Fusha me performancën më të ulët është kanalizimi. Në këtë fushë komunat nuk kanë ofruar të dhëna valide për numrin e vendbanimeve të përfshira në sistemin e trajtimit të ujërave të zeza. Pasaktësia e madhe e të dhënave ka bërë që ky tregues të shpallet i pavlefshëm në tërësi, në mënyrë që të mos reflektoj performancë të pavërtetë.
8. Një pjesë e komunave kanë filluar aplikimin online të shërbimeve administrative. Këto shërbime duhet të aplikohen në të gjitha komunat dhe për numër më të madh

- të shërbimeve, përfshirë aplikimin online për leje ndërtimore, leje mjedisore, pagesat e tatimit në pronë, apo faturat për shërbime komunale;
9. Vetëm 27.78% e komunave kanë dëshmuar ta kenë diskutuar në Kuvendin e Komunës planin e integritetit, 32% raportin e auditorit të brendshëm dhe 50 % Raportin e performancës komunale për vitin paraprak. Këto plane dhe raporte duhet të bëhen pika diskutimi rutinore për çdo vit në kuvendet komunale me qëllim që të forcohet niveli i përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së ekzekutivit para kuvendit dhe qytetarëve.
 10. Të dhënat për shërbimet sociale tregojnë se drejtoritë komunale duhet të jenë më efektive në vlerësimin e familjeve në banim social, në mënyrë që të objektet e banimit social të shfrytëzohen nga familjet në nevojë dhe të ketë shqyrtim të plotë të kërkesave të parashtruara;
 11. Planifikimi hapësinor kërkon trajtim më të gjerë për të rregulluar të gjithë sipërfaqet e nevojshme me plane rregulluese të hollësishme. Të dhënat flasin për një shkallë mjaft të ulët të këtyre planeve të cilat janë tejet të rëndësishme për rregullimin e komunës;
 12. Infrastruktura rrugore duhet të kompletohet, si në aspektin e asfaltimit të rrugëve, ashtu edhe me infrastrukturë përcjellëse përfshirë trotuare dhe ndriçim publik. Drejtoritë komunale për infrastrukturë duhet të planifikojnë më mirë aktivitetet oër mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale, përmes kontraktimit të operatorëve përkatës.
 13. Gjithashtu, komunat duhet të punojnë në avancimin e infrastrukturës rrugore përmes krijimit të shtigjeve të biçikletave sidomos në zonat urbane, si dhe zgjerimin e trotuareve për vendbanimet rurale;
 14. Komunat duhet të planifikojnë dhe bashkëpunojnë për të siguruar trajtim të ujërave të zeza paralelisht me zgjerimin e rrjetit të kanalizimit. Trajtimi i ujërave të zeza është i shprehur në masë tejet të ulët, marrë parasysh koston e lartë të këtij shërbimi. Komunat duhet të shqyrtojnë edhe mundësitë e burimeve të tjera financiare për krijimin e impiantëve, në mënyrë që të evitohen shumë probleme mjedisore dhe të mbrohet shëndeti publik.
 15. Sasia e deponimit të mbeturinave në komunat e Kosovës është mjaftë e ulët krahasuar me mesataren e Bashkimit Evropian (për kokë banori) dhe komunat duhet të sigurohen që mbeturinat e grumbulluara deponohen në deponi legale dhe se ato nuk përfundojnë në deponi ilegale ku nuk regjistrohet si sasi e deponuar.
 16. Gjatë procesit të planifikimit të buxhetit, komunat duhet të përpilojnë dhe të formulojnë pjesën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor sipas kriterëve ligjore. Politikat lokale duhet të vlerësojnë ndikimin gjinor, ashtu që burimet financiare të ndahen proporcionalisht për të dy gjinitë. Kërkohet promovim më i madh i politikave gjinore në këshillat e lokale. Rreth 33% e komunave duhet të hartojnë planet për barazi gjinore. Kriteri i barazisë gjinore duhet të forcohet edhe në kuadër të pozitave të emëruara politike, si dhe të promovohet e drejta për regjistrimin e pronësisë në të dy gjinitë e cila qëndron në vlerë mjaft të ulët.
 17. Komunat duhet të fillojnë të investojnë në çerdhe/kopshte në zona rurale ku ka nevojë, për shkak të rëndësisë së këtyre institucioneve në zhvillimin e hershëm të fëmijëve.
 18. Drejtoritë komunale të arsimit duhet të planifikojnë që shkollat të plotësojnë kushtet e infrastrukturës përcjellëse, masat e energjisë efijente, si dhe të jenë të

pajisura me kabinete me internet në masë më të madhe. Krijimi i hapësirave shkollore sidomos në zonat urbane kërkojnë trajtim të veçantë për të eliminuar mësimin në më shumë turne dhe aplikimin e mësimit gjithditor.

19. Standardi një mjek familjar dhe dy infermierë për 2000 banorë duhet ngritët ne pajtim me kriteret ligjore;
20. Planifikimi formal për zhvillim ekonomik lokal duhet të zgjerohet në komuna. Raportimi për realizimin e planeve të tilla duhet të jetë temë e diskutimit në kuvendet komunale, në mënyrë që të aktivitetet në këtë fushë të gjejnë zbatim më të lehtë dhe të prioritizohen sipas kërkesave të shumësisë.

Shtojcë: % e treguesve sipas fushave

SHËRBIMET ADMINISTRATIVE	1.1.1	Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit	92.66
	1.1.2	Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	88.19
	1.1.4	Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna	30.56
TRANSPARENCA KOMUNALE	2.1.1	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt online	59.13
	2.1.2	Niveli i qasje në dokumente publike nga qytetarët	87.31
	2.1.3	Përmbushja e kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës	70.83
	2.1.4	Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal, në faqën zyrtare të komunës	77.37
	2.1.5	Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqën zyrtare të komunës	64.79
	2.2.1	Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit	77.78
	2.2.2	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik dhe i kontratave	70.18
PËRGJEGJSHMËRIA KOMUNALE	3.1.1	Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike	83.33
	3.1.2	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike	53.79
	3.1.3	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	67.15
	3.1.4	Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal	90.51
	3.1.5	Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	0.00
	3.1.6	Këshillat lokal që kanë mbajtur së paku 6 takime në vit	54.11
	3.1.7	Intervenimet për mbledhje të mbeturinave nga raportimet e qytetarëve	57.68
	3.1.8	Intervenimet në shpërthimet në ujëra të zeza	65.11
	3.2.1	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	88.61
	3.2.2	Diskutime për raportet buxhetore tre-mujore nga Kuvendi Komunal	84.72
	3.2.3	Diskutim për raportin e performancës komunale nga kuvendi komunal për vitin paraprak	50.00
	3.2.4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Asamblenë Komunale	75.00
	3.2.5	Diskutimi i raportit të auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit në Asamblenë Komunale	31.94
	3.2.6	Mbledhje të Kuvendit me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	62.24
	3.3.1	Niveli i zbatimit të planit të prokurimit	77.64

	3.3.2	Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve	73.61
	3.3.3	Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit	30.13
	3.4.1	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal	27.78
	3.4.2	Suspendimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre	93.06
	3.5.1	Zbatimi i skemës për shpërndarjen e vlerësimeve të punës për shërbyesit civil	72.56
	3.5.2	Vende të hapura të punës që janë procesuar përmes SIMBNj	83.62
	3.5.3	Kontratat për shërbime të veçanta janë në pajtueshmëri me kornizën ligjore	50.12
BARAZIA NË PUNËSIM, SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE	4.1.1	Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale	23.19
	4.1.2	Të punësuar nga komunitetet jo-shumicë	59.38
	4.2.1	Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi dhe janë krijuar kushtet për lëshim të banimit social	60.28
	4.2.2	Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar	85.34
KULTURË, RINI DHE SPORT	5.1.1	Hapësira për aktivitete sportive për numër të banorëve	67.68
	5.2.1	Aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal	79.23
	5.2.2	Pjesëmarrja e qytetarëve në veprimtari për kulturë, rini dhe sport	57.37
MENAXHIMI I FATKEQËSIVE	6.1.1	Niveli i realizimit të planit komunal për menaxhimin e fatkeqësive	68.48
	6.1.2	Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë	85.90
PLANIFIKIMI HAPSINOR KOMUNAL	7.1.1	Sipërfaqja e territorit të komunës i mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme)	14.05
	7.2.1	Kërkesa të shqyrtura për leje të ndërtimit	85.55
	7.2.2	Ndërtesa të reja të inspektuara	73.86
	7.2.3	Objekte të reja me leje të ndërtimit	69.86
HAPËSIRAT PUBLIKE	8.1.1	Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m2 për kokë banori	11.88
	8.1.2	Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht	67.46
	8.1.3	Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik	75.40
INFRASTRUKTURA RRUGORE	9.1.1	Rrugët lokale të shtruara	71.83
	9.1.2	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës	54.57
	9.1.3	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit	64.98
	9.2.1	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare	9.15
	9.2.2	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik	15.03

	9.2.3	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal	52.61
	9.2.4	Rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave	5.89
	9.2.5	Rrugët lokale të riasfaltuara	66.00
TRANSPORTI PUBLIK	10.1.1	Realizimi i planit komunal për transport lokal publik	66.55
	10.1.2	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	65.47
	10.1.3	Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik	60.38
PARKINGJET PUBLIKE	11.1.1	Numri i parkingjeve për parkimin e mjeteve motorike	26.03
	11.1.2	Vendparkimet për mjete motorike në territorin e komunës	15.22
	11.1.3	Vendparkimet e destinuara për taksì	55.62
	11.1.4	Numri i parkingjeve me vendparkime të rezervuara për persona me aftësi të kufizuar	50.40
UJË I PIJSHËM	12.1.1	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit	72.33
	12.1.2	Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm	73.87
KANALIZIMI	13.1.1	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit	74.64
	13.1.2	Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e kanalizimit	71.42
	13.2.1	Vendbanimet e përfshira në sistemin për trajtim të ujrave të zeza	0.00
MENAXHIMI I MBETURINAVE	14.1.1	Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave	78.27
	14.1.2	Ekonomitë familjare që kanë qasje në sistemin e grumbullimit të mbeturinave	70.10
	14.2.1	Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave	87.77
	14.2.2	Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave	73.35
	14.3.1	Sasia e deponimit të mbeturinave në kilogram për kokë banori	50.35
MBROJTJA E AMBIENTIT	15.1.1	Realizimi i planit të veprimit lokal në mjedis	64.49
	15.1.2	Lejet mjedisore komunale të lëshuara	75.57
	15.1.3	Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale	56.85
PERFAQESIMI GJINOR	16.1.1	Gratë e punësuar në institucione/administratën komunale	80.66
	16.1.2	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive	59.02
	16.1.3	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	50.95
	16.1.4	Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale	65.08

	16.1.5	Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale	6.40
	16.2.1	Buxheti dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor	51.39
	16.2.2	Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave	36.33
	16.2.3	Pjesëmarrja e grave në takime publike	47.11
	16.2.4	Plani komunal për barazi gjinore	66.67
	16.3.1	Barazia gjinore tek emërtimet e rrugëve	11.67
	16.3.2	Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive	12.17
ARSIMI PARAUNIVERISTAR	17.1.1	Çerdhe dhe kopshte në zona rurale për 10000 banorë	1.00
	17.1.2	m ² të hapësirave për nxënës – urban dhe rural	42.25
	17.1.3	Shkollat e pajisura me kabinet të TIK	58.48
	17.1.4	Shkollat me masa të eficiencës së energjisë	50.89
	17.1.5	Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar	64.19
	17.1.6	Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar	57.53
	17.2.1	Mësimdhënësit që i plotësojnë kriteret e kualifikimit të licensuar	83.29
	17.2.2	Niveli i pajtueshmërisë me raportin nxënës për mësimdhënësit - urban dhe rural	67.46
	17.2.3	Plotësimi i buxhetit për arsim prej të hyrave vetanake	7.04
	17.2.4	Plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs të rregullt	87.61
	17.2.5	Plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs plotësues	90.47
	17.2.6	Respektimi i procedurave ligjore për zgjedhjen e stafit drejtues të shkollave (drejtorëve dhe zv.drejtorëve)	91.11
	17.3.1	Fëmijët që vijnë në kopshtin - rural dhe përgjithësi (ndarje sipas gjinisë)	4.91
	17.3.2	Shkalla bruto e regjistrimit në kl.1	94.51
	17.3.3	Shkalla e qasjes – tranzicioni kl9- k10	93.91
	17.3.4	Rezultatet e testit të arritshmërisë për kl.9-ta	59.52
	17.3.5	Kalueshmëria në maturën kombëtare kl.12-të (ndarja sipas gjinisë)	74.62
	17.3.6	Indeksi i barazisë gjinore (për të gjitha nivelet ISCED 0-3)	79.45
	17.3.7	Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse)	97.17
	17.3.8	Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit	93.97

SHENDETESIA PRIMARE	18.1.1	m2 të hapësirave KPS për 10000 banorë	71.48
	18.1.2	Objektet e KPS që janë të pajisura sipas udhëzimit administrativ edhe shërbimet laboratorike	36.40
	18.2.1	Niveli i pajtueshmërisë me raportin 1 mjek familjar edhe 2 infermier për 2000 banorë	69.61
	18.2.2	Përqindja e buxhetit për kujdes primar shëndetësor të mbështetur nga komunat prej të hyrave vetanake	5.97
	18.3.1	Numri i vizitave të pacientëve në kujdesin primar shëndetësor për kokë banori	36.78
	18.3.2	Fëmijët e përfshirë në programin e imunizimit	94.87
	18.3.3	Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe fëmijë	67.96
ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL	19.1.1	Plani për zhvillim ekonomik lokal	55.56
	19.1.2	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim	59.72
	19.1.3	Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë	70.20
	19.1.4	Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	51.91